



UNIVERSITETI I GJAKOVËS  
"FEHMI AGANI"  
UNIVERSITY OF GJAKOVA

Kryesuesi i Këshillit Drejtues  
Dr.Sc. Mazllom Kumnova

Nr.prot.: 05/1900  
Datë: 10/12/2020

Në bazë të nenit 22, paragrafi 1, pika 1.7 dhe nenit 23, të Statutit të përkohshëm të Universitetit të Gjakovës "Fehmi Agani", Këshilli Drejtues, në mbledhjen e mbajtur me datë 09.12.2020, mori këtë:

V E N D I M

- I. Për ndryshimin e Rregullores për të ardhura të personelit akademik, shtesat për funksione, honoraret dhe komisionet e përhershme në Universitetin e Gjakovës "Fehmi Agani".
- II. Neni 8, paragrafi 1.2, pika 1, i Rregullores për të ardhura të personelit akademik, shtesat për funksione, honoraret dhe komisionet e përhershme në Universitetin e Gjakovës "Fehmi Agani" me nr.05/1595/2, i datës 21.10.2019, ndryshohet si vijon "Personeli akademik është i obliguar që gjatë vitit akademik pa pagesë në cilësinë e mentorit të jetë në pesë (5) raste dhe anëtarë komisioni (kryetar, anëtar) në pesë raste.  
*Personeli akademik mund të jetë në cilësinë e mentorit me pagesë për (15) pesëmbëdhjetë raste të temës së diplomës dhe (15) raste si anëtar.  
Për raste të veçanta, me arsyetim me shkrim Dekani mund të lejoj edhe tejkalimin e këtij numri, por jo më shumë se pesë (5).*
- III. Neni 15, tabela 6, ndryshohet si vijon:
- IV.

<b>Fakultete</b>	<b>Ligjërata obligative</b>	<b>Ligjërata zgjedhore</b>	<b>Ushtrimet për lëndët obligative / zgjedhore</b>
<i>F. Filologjik</i>	<i>Deri 30</i>	<i>Deri 30</i>	<i>Deri 30</i>
<i>F. Edukimit</i>	<i>Deri 30</i>	<i>Deri 30</i>	<i>Deri 30</i>
<i>F. Mjekësisë</i>	<i>Deri 25</i>	<i>Deri 25</i>	<i>Deri 15</i>
<i>F.Shkencave Sociale</i>	<i>Deri 30</i>	<i>Deri 30</i>	<i>Deri 30</i>

Dhe shtohet fjalia si më poshtë:

*Praktika klinike, në fakultetin e mjekësisë duhet të ketë jo më shumë se 8 (tetë) studentë për grup.*

- V. Ky vendim hyn në fuqi nga dita e miratimit në Këshillin Drejtues, si aneks i Rregullores për të ardhura të personelit akademik, shtesat për funksione, honoraret dhe komisionet e përhershme në Universitetin e Gjakovës “Fehmi Agani”.

### Arsyetim

Këshilli Drejtues pasi shqyrtoj propozimin e Rektorit të Universitetit të Gjakovës “Fehmi Agani” e konsideroi të arsyeshëm ndryshimin e nenit 8, paragrafi 1.2, pika 1, dhe nenit 15, prandaj bazuar në Statutin e Universitetit, në mbledhjen e mbajtur me datë 09.12.2020 vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Ky vendim i dorëzohet:

1. Menaxhmentit të UGJFA-së
2. Sekretares së Përgjithshme
3. Arkivit të UGJFA-së



**Kryesuesi i Këshillit Drejtues**

Dr. Sc. Mazllo Kumnova